(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet)*: Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit /entit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

1. Përshkrime të përgjithshme

Qëllimi i këtij investimi është riparimi i linjes kabllore 110kV L110-4/2a Traktora - Farkë e cila ka pësuar demtim në tre fazet e sajë.

Nepermjet këtij projekti synohet riparimi i linjes së demtuar duke realizuar perkatesisht 2 mufte për secilën fazë dhe ndërrimin e kabllit në një segment prej 20 ml.

Gjithashtu si pjesë e këtij projekti parashikohet furnizimi i 6 muftëve rezerv për linjat 110kV

Duhet të furnizohen materialet dhe të kryhen punimet si më poshtë :

- | | |
|--|-----------|
| a. Muftë 110 kV TL, AL, XLPE të drejta dhe instalimi tyre | cope 3 |
| b. Muftë 110 kV TL, AL, XLPE me nxjerrje skermo për tokezim dhe instalimi tyre | cope 3 |
| c. Punime civile për hapjen e kanalit të kabllit 110 kV | ml 20 |
| d. Shtrirja e kabllit të ri në të njëjtin pozicion me ekzistuesin | ml 20 |
| e. Realizimi i tokezimit të muftës 110kV | komplet 1 |
| f. Kthimin në gjendjen fillestare | |
| g. Furnizim muftë 110 kV TL, AL, XLPE me nxjerrje skermo për tokezim (rezerve) | cope |
- 6

Kablli 110 kV i cili do të përdoret për riparim do të furnizohet nga kontraktori.

1.2. Te dhena teknike

Tabela e mëposhtme përshkruan kushtet e përgjithshme në të cilat kabllot dhe Aksesorët shoqërues të kabllëve duhet të jenë në gjendje të punojnë pa asnjë degradim:

Nr.	Parametrat	Performanca
1	Jetegjatesia e projektit	40 vjete
2	Gjendja e neutrit	Tokezim solid
3	Tensioni nominal i sistemit	110kV
4	Tensioni Fazë – toke	64 kV
5	Tensioni maksimal	123 kV
6	Qendrueshmeria ndaj tensionit impulsiv	550 kV
7	Rrymat e Lidhjes së shkurtër 3 fazore	25 kA per 1s
8	Rrymat e Lidhjes së shkurtër 1 fazore	25 kA per 1s

1.3. Standartet

- IEC 60840: Power Cables with extruded insulation and their accessories for rated voltages up to 150kV ($U_m = 170kV$) – Test methods and requirements
- HD 632.2 2008: Power cables with extruded insulation and their accessories for rated voltages above 36 kV ($U_m = 42 kV$) up to 150 kV ($U_m = 170 kV$)
- IEC 60228: Conductors of insulated cables

- IEC 60229: Tests on cable oversheaths which have a special protective function and are applied by extrusion
- IEC 60811: Common test methods for insulating and sheathing materials of electric cables
- IEC 60287: Electric cables – Calculation of the current rating
- IEC 60853: Calculation of the cyclic and emergency current rating of cables
- IEC 949: Calculation of thermally permissible short-circuit currents, taking into account non-adiabatic heating effects
- CIGRE Technical Brochure No. 272 – Large cross sections and composite screens design
- ENA-ER-C55/4: Insulated Sheath Power Cable Systems
- BS EN 206-1:2000 Concrete Part 1: Specification, performance, production and conformity
- BS EN 124:1994 Gully tops and manhole tops for vehicular and pedestrian areas. Design requirements, type testing, marking, quality control.
- IEC 60794-1-1: Optical fiber cables. Generic specification. General
- IEC 60794-1-2: Optical fiber cables. Generic specification. Basic optical cable test procedures IEC 60793-1-1: Optical fibers. Measurement methods and test procedures. General and guidance ITU G.652: Characteristics of a single-mode optical fiber cable
- IEC 61753-1 Fiber optic interconnecting devices and passive components performance standard
- Telcordia GR -326: Generic Requirements for Single-Mode Optical Connectors and Jumper Assemblies

2. Linja kabllore 110 kV

2.2.Rryma nominale e linjes

Linja ekzistuese kabllore eshte ndertuar me kablllo me izolacion XLPE me seksion 800 mm^2 te vendosur drejtperdrejt ne toke ne nje thellesi 1.1 ml dhe ne nje gjeresi kanali 0.8m me kablllo te distncuar 2D. Kablli I ri I cili do te instalohet per riparim do te vendoset sipas te njejtut konfigurim me ate egzistues me qellim ruajtjen e parametrave te linjes.

2.3.Rrymat e Lidhjes se Shkurter

Qarku i tokëzimit përbëhet nga skermo/ekranet metalike të kabllit 110 kV, kabllot lidhëse, kabllot e tokëzimit dhe aksesoret përkatës, janë projektuar, prodhuar dhe instaluar për të siguruar pa asnjë degradim perballimin e rrymës së nevojshme të lidhjes së shkurtër njëfazore, kabllot ekzistues jane me skermo CU me seksion 95 mm^2

Materialet e reja qe do te instalohen duhet të projektohet dhe prodhohet për perballimin e rrymave te qarkut të shkurtër njëfazor të përmendur më sipër.

2.4.Tokezimi I skermos se kablllove

Në mënyrë që te ruhet regjimi i punes dhe skema aktuale e tokezimit te skermos se kablllove muftet e reja do te jene 2 te dy tipeve te ndryshme, me nxjerrje skermoje per tokezim dhe mufte te drejta. Bashkimi do te behet me gilza me seksione te pershtateshme per perballimin e rrymave te LSH deri 25 kA.

Do te perdoret kaseta ekzistuese per tokezimin e skermove te kabllit ndersa sistemi I tokezimit do te behet I ri, gjithashtu do te behet riparimi I percjellesit te tokezimit kuke siguruar vazhdimesine e tije dhe lidhjen me sistmin e ri te tokezimit te muftes 110kV

2.5.Ndertimi I kanalit te kablllove

Gërmimi i kanaleve do të planifikohet në një mënyrë për të minimizuar ndërprerjet dhe kufizimet e aksesueshmërisë. Punimet e ndërtimit do të kryhet në përputhje me legjislacionin e Sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit. Zona ku do të kryhen punimet është zone pa infrastrukturë të rënduar nentokesore për këto qëllime punimet do të organizohen me krahe dhe makineri. Në rast se demtohet infrastruktura ekzistuese nëntokesore, përkatësisht kabllot e energjisë, kabllot e telekomit, tubacione gazi, tubacione uji dhe infrastruktura të cdo lloji tjetër, Kontraktori do të përpiqet të riparojë menjëherë dëmet e shkaktuara. Për më tepër, Kontraktori do të jetë përgjegjës për humbjet e shkaktuara nga ndërprerjet që rezultojnë nga dëmet e shkaktuara nga Kontraktuesi.

Gjerësia totale e kanalit duhet të jetë e mjaftueshme për:

- Mbrojtjet e nevojshme për muret e kanalit;
- Hapësira horizontale shtesë e kërkuar për lëvizshmërinë e punëtorëve dhe sigurinë.

Rrezja minimale e përkuljes për kanalet përgjatë rrugës së kablllove, duhet të jete në përputhje me kërkesat e prodhuesit të kablllove dhe presionit maksimal në muret anësore por në asnjë rast me e vogël se 2.7 m.

Dheu që përdoret për të mbushur kanalën nuk duhet të ketë materiale organike, argjilë dhe gurë. Duhet të zgjidhet një kombinim adekuat të madhësisë së kokrrizave dhe ngjeshjes në mënyrë që të përputhet me rezistencën termike të mbushjes së kërkuar për vlerësimin e performancës së kablllove.

Mbushja duhet të jetë e përshtatshme për të perballuar:

- qendrueshmëri mekanike të trasës së kablllove,
- nenkalimet dhe mbikalimet e infrastruktures ekzistuese,
- rrjedhat ujore,
- erozioni i tokës dhe rrëshqitjet e dheut.

Pas mbushjes së kanalit, duhet të rivendoset sipërfaqe origjinale në çdo zonë e dëmtuar gjatë procesit të ndërtimit.

Të gjitha mbetjeve nga procesi i ndërtimit, dhe trajtimi do të kryhet në përputhje me legjislacionin lokal në fuqi.

Pas instalimit të xhuntove mbi kabllin do të aplikohen provat e mëposhtme:

- Prova me megër minimalisht 2500V
- Prova me tension të lartë të rrymës së vazhduar
- Prova me tension alternativ përpara venies në shfrytëzim

Provat e mësipërme do të ekzekutohen në përputhje me IEC 60840 dhe IEC 60502.

2.6.Aksesoret

Xhuntot për kablllo 110 kV duhet të jenë të realizuara në mënyrë të tillë që, të ofrojnë cilësitë më të mira të teknologjisë për polimeret që tkurren në nxehtësi dhe atë prej silikoni me formë të parapërgatitura dhe të derdhura që në fabrikë si dhe të kombinuar me eksperiencën e karakteristikave të materialeve me afat të gjatë kohor nën tension dhe veprimin e ambientit të jashtëm.

Parimet bazë të teknologjisë së kërkuar për këto xhunto dhe terminale 110 kV janë:

Izolimi kryesor të jetë i para-derdhur

Të realizojë uniformizimin e fushës elektrike dhe të ofrojë:

- diapazon të gjerë aplikimesh
- instalim të lehtë dhe të mos kërkojë pajisje tërheqëse

Lidhjet me ekranet metalike të kabllit duhet të realizohen në mënyrë të tillë që këto lidhje të :

- Mos përbejnë rrezik për dëmtimin e kabllit
- Të realizojnë instalim të lehtë
- të krijojnë adoptim të lehtë në kabllot me dy ose me shumë shtresa mbrojtëse

Sistemi i jashtëm hermetizues duhet të jetë me termotkurrje

Sistemi i jashtëm hermetizues duhet të jetë me termotkurrje dhe këto polimere me lidhje të kryqezuar me termotkurrje dhe me mastike hermetizuese të termoshkrirshme duhet të realizojnë :

- izolim të sigurtë ndaj lagështisë
- mbrojtje mekanike e trupit të xhuntos

2.6.1. Xhuntot për kabllot 110kV

Ky specifikim mbulon bashkueset (muftet) e kabllëve 110 kV (bëj kujdes se sistemi i tensioneve është 64/110/123 kV), me përcjellës alumini 800 mm² me izolim XLPE.

Kriteret e projektimit të xhuntovë dhe materialet që përdoren

Konstruksioni i xhuntos duhet të jetë projektuar në mënyrë të tillë që të rikostitujë nga pikëpamja elektrike dhe mekanike ndërtimin e vetë kabllit. Rrjeta e bakrit që përdoret si skermë dhe që mbulon të gjithë trupin e xhuntos duhet të jetë jo më e vogël se 95 mm².

Skërma e xhuntos duhet të lidhet në mënyrë solide me skërmën e kabllit.

Palltoja e jashtme që aplikohet mbi xhunton pas përfundimit të saj duhet të jetë krejtësisht hermetike që të sigurojë një izolim të plotë të izolacionit të kabllit dhe muftes, si dhe pikave të tyre bashkuese nga ambienti i jashtëm. Ajo gjithashtu duhet të jetë mekanikisht e qëndrueshme ndaj goditjeve dhe sforcimeve mekanike, si dhe rrezatimit ultraviolet. Përcjellësit e kabllit në të dy skajet duhet të bashkohen me gilza që duhet të jenë plotësisht në përputhje me kërkesat e standartit IEC -1238-1 .

E gjithë xhuntoja duhet të kënaqë kërkesat e standartit IEC 60 840.

Xhuntot duhet të jenë të projektuara për tension nominal 110 kV në sistemin elektrik me të dhënat e paraqitura në paragrafin 1.

Xhuntot duhet të jenë të konstruara në mënyrë të tillë që të plotësojnë këto kërkesa:

- Xhunto duhet të jetë e parafabrikuar si dhe të jenë të testuara në fabrikë.
- Lidhja elektrike e dejeve duhet të realizohet me bullona përcjellës me përdredhje të kontrolluar
- Duhet të ketë të integruar një sistem me termotkurrje i cili të bllokojë depertimin papastërtive dhe lagështisë
- Të ofrojë dimensione të vogla dhe hapje të vogël të vendit të punës.
- Pjesët përbërëse prej silikoni të parafabrikuara duhet të jenë të testuara në fabrikë

Konstruksioni i xhuntos duhet të përmbajë konektorin bashkues, konin për uniformizimin e fushës elektrike dhe trupin e xhuntos si dhe duhet të ketë të realizuar « kafazin e Faradeit » në të, si dhe sistemin e hermetizimit që duhet të jetë i realizuar me teknologjinë me termotkurrje. Lidhja elektrike e përcjellësve të kabllit duhet të realizohet me anën e konektorëve me vide të kontrolluar në përdredhje. Këto lloj konektorësh duhet të jenë të përshtatshëm për përcjellësat e përdredhur prej alumini ose bakri dhe të mund të modifikohen për të pranuar gjithashtu aplikimin në to edhe të përcjellësve solid të kabllove.

Uniformizimi i fushës duhet të realizohet nga koni prej silikoni dhe ky duhet të sigurojë kontrollin e fushës elektrike si dhe duhet të instalohet lehtësisht falë elasticitetit të tij shumë të mirë.

Lidhjet elektrike dhe ato të ekranit duhet të realizohen pa saldim.

Hermetizimi i jashtëm duket të realizohet me anën e sistemeve hermetizuese me termotkurrje dhe ngjitje të cilat duhet të garantojnë një hermetizim pefekt dhe padepertueshmëri të lagështisë apo papastertive brenda trupit të xhuntos.

Testimi

Testimi i Xhuntove në kabllot 110 kV duhet të behet në përputhje me standartet IEC 60840 dhe IEEE 404. Ofertuesi duhet të dorëzojë një raport të plotë testimi për provat e tipit të muftëve 110 kV që do të ofrojë. Raporti duhet të jetë një raport i testimit të muftëve identike me ato që do të livrohen në këtë kontratë. Raporti duhet të përmbajë të dhënat e plota të dala nga testimi dhe ai duhet të jetë konceptuar dhe hartuar në përputhje me kërkesat e standartit kodifikues Cenelec 629 1S1.

Cdo muftë duhet ti nënshtrohet provave rutine, si qëndrueshmërisë ndaj tensionit alternativ 50 HZ për një orë, si dhe rezistencës së xhuntove nën ujë, në mjegull në ujë të kripur apo ndonjë provë tjetër speciale, gjithmonë në përputhje me provat speciale të parashikuara në standartin IEC.

Punëmarrësi duhet të furnizojë gjithë materialin e nevojshëm për të kryer vendosjen në punë të kabllit si mishelë izolante etj.

2.6.2. Kabllot e lidhjes dhe kabllot paralele të tokëzimit

Kabllot e lidhjes dhe kabllot paralele duhet të projektohen, prodhohen dhe instalohen për të perballuar rrymat e qarkut të shkurtër të përshkruar në kete projekt pa asnjë degradim fizik. Seksioni terthor minimal i bakrit për kabllot e lidhjes me një bërthamë dhe kabllot paralele të tokëzimit duhet të jenë $1 \times 120 \text{ mm}^2$. Përcjellesi i bakrit duhet të jetë në përputhje me IEC 60228 klasa 2 (compacted).

Për kabllot e lidhjes se skermos, seksioni terthor minimal prej bakri duhet të jetë $2 \times 120 \text{ mm}^2$.

2.7. Projektimi i kabllit

Karakteristikat konstruktive dhe teknike të kabllit duhet të garantohen nga teste tip dhe testet rutinë që do të kryhen në përputhje me normat IEC.

Kabli do të perbehë nga përcjellës alumini 800 mm^2 , ekran gjysmëpërcjellës, izolues politilieni (XLPE), ekran gjysëm përcjellës mbi materialin izolues ndërtoar prej materiali igroespandente, ekran me fije bakri dhe guainë (mbështjellës) një njëstresore dhe në fund një veshje politilieni të jashtëme.

Ndërtimi dhe përberja e elementëve të ndryshëm përbërës të kablrit jepen në paragrafet që vijojnë.

2.7.1. Përcjellësi

Përcjellësi do të jetë ndërtuar në formën e një korde e rumbullaktë të përbërë nga një tufë fijesh alumini në përputhje me Normativën IEC 60228 për përcjellësit si dhe izolim gjatesore nga uji duke mbushur hapsirat ndermjet dejeve me materiale te pershtateshme izoluese.

2.7.2. Ekran mbi përcjellës

Ekran mbi përcjellës do të përbëhet nga një shtresë polimere gjysëmpërcjellëse e heqëshme. Heqja e kësaj shtrese do të kryhet njëkohësisht me heqjen e shtresës izoluese, në mënyrë që të garantohet përputhja e plotë midis dy shtresave polimere. Shtresa gjysme percuese duhet te jete e vazhdueshme dhe te mbuloje komplet siperfaqen e percjellesit.

2.7.3. Izolimi

Izolimi do të përbëhet nga një shtresë polietileni (XLPE) e përshtatëshme për temperaturë pune të përcjellësit prej 90°C dhe 250 °C në kushte të lidhjes së shkurtër. Materiali izolues do të hiqet njëkohësisht në ekranet mbi përcjellës dhe mbi izolantin (tripla estrusione).

Materiali izolues XLPE, duhet te kete nje trashesi minimale qe ruaje ngarkesat elektrike per $U_0=64kV$ nen :

- ≤ 6.3 kV/mm over the conductor screen
- ≤ 3.6 kV/mm over the insulation screen.

2.7.4. Ekran gjysëmpërcjellës mbi izolant

Ekran mbi izolant do të përbëhet prej një shtrese polimere gjysëmpërcjellëse të heqëshme. Heqja e kësaj shtrese do të bëhet njëkohësisht me atë të ekranit mbi përcjellës dhe me izolantin. Në këtë mënyrë ekran mbi izolues do të mbetet i ngjitur fort mbi izoluesin.

Trashësia mesatare duhet të jetë ≥ 0.2 mm

2.7.5. Mbrojta gjatesore kundrejt depertimit të ujit

Para vendosjes së ekranit metalik, kablli do të fashohet me anë të një materiali nastro igrozgjerues që kanë si funksion kufizimin e depertimit gjatësor të ujit në zemër të kabllit në rast dëmtimi të kabllit.

2.7.6. Ekran metalik

Ekran metalik do te perbehet nga nje ekran me fije bakri i veshur me nje shtrese nastroje alumini monopllake i cili vendoset ne drejtim gjatesor. Seksioni I ekranit metalik duhet te jet I tille qe te mbyllen rrymat e lidhjes se shkurter 1 fazore dhe temperatura finale te mos shkoje me shume se 250°C duke marre temperature fillestare te percjellesit prej 90°C.

2.7.7. Mbrojta gjatesore kundrejt depertimit të ujit

Midis ekranit me fije bakri dhe guainës prej alumini, kablli do të fashohet me nastro igroespandente, të cilat kanë si funksion kufizimin e depertimit gjatësor të ujit në zemër të tij në rast dëmtimi të kabllit.

2.7.8. Mbrojta e jashteme

Guaina e jashtëme do të përbëhet nga një shtresë polimere material polietileni i heqshëm në gjëndje që të mbrojë mekanikisht shtresën metalike dhe të shërbejë si pengesë kundër depertimit të ujit.

Mbi guainen PE do të vendoset një shtrese e lehtë grafiti e nevojshme për të kryer testimet elektrike pas vendosjes në përputhje me sa parashikohet në normën IEC 60840.

3. Kerkesat teknike per paisjet dhe materialet (data sheets)

<i>Te dhenat teknike (Technical Data Sheets - 110 kV Underground Lines)</i>				
Nr.	Pershkrimi	Kerkesat minimale		Te ofertuarat
		Njesi	Vlera	Vlerat
1	Te pergjitheshme			
	Tensioni me i larte i sistemit	kV/Hz	123/50	
	Tensioni Nominal	kV	110	
	Qendrueshmeria ndaj tensionit impulsive	kV, peak	550	
	Qendrueshmeria ndaj tensionit me frekuence industriale	kV, r.m.s	160	
	Sistemi i neutrit	-	Tokezim solid	
2	Parametrat kryesore te projektimit			
	Temperatura e tokes ne thellesine e vendosjes se kabllit	°C	+20	
	Rezistenca termike e tokes	K.m/W	1.2	
3	Muftet 110 kV			
	Tipi		Parafabrikuar	
	Tensioni (U ₀ /U (U _m))	kV	64/110 (123)	
	Lidhja e percjellesit	--	Gilza me shtrengim	
	Seksioni i percjellesit	mm ²	800	
	Percjellsit per lidhjen e skermos		CU fleksibel 2x120mm ²	
	Qendrueshmeria ndaj tensionit impulsiv	kV	550	
	Qendrueshmeria ndaj tensionit me frekuenc industriale test (30 min)	kV	160	
	Shkarkesat maksimale te testuara na 1.5 x U ₀	pC	5	
3	Kabllot 110 kV			
	Te pergjitheshme			
	Niveli tensionit (U ₀ /U/U _m)	kV	64/110/123	
	Te dhenat e percjellesit			
	Seksioni minimal	mm ²	800	
	Materiali		Alumin	
	Ndertimi		Rrethor I ngjeshur sipas	

Te dhenat teknike (Technical Data Sheets - 110 kV Underground Lines)

Nr.	Pershkrimi	Kerkesat minimale		Te ofertuarat
		Njesi	Vlera	Vlerat
			IEC 60228 klasi 2	
	Ekрани gjysëmpërçues mbi percjelles			
	Materiali		Extruded semiconductive compound crosslinked (supersmooth)	
	Spesori nominale	mm	1.2	
	Spesori minimal	mm	0.8	
	Stresi elektrik maksimal mbi ekranin e percjellesit	kV/mm	6.3	
	Izolimi			
	Materiali		Cross-Linked Polyethylene (XLPE)	
	Trashesia nominale	mm	15	
	Trashesia minimale	mm	13.5	
	Ekрани gjysëmpërçues mbi izolacion			
	Materiali		Extruded semiconductive compound crosslinked (supersmooth)	
	Spesori nominale	mm	1.2	
	Spesori minimal	mm	0.8	
	Stresi elektrik maksimal mbi ekranin e izolacionit	kV/mm	3.6	
	Tamponiuesi (Bllokuesi) gjatësor		Shirit igroespendente	
	Skermo metalike			
	Materiali		Percjelles bakrri	
	Seskioni minimal	mm ²	95	
	Materiali i spirales		Percjelles bakrri	
	Seksioni minimal i spirales se skermos	mm ²	1	
	Shtresa e jashtme			
	Materiali		HDPE (ST7)	

Te dhenat teknike (Technical Data Sheets - 110 kV Underground Lines)

Nr.	Pershkrimi	Kerkesat minimale		Te ofertuarat
		Njesi	Vlera	Vlerat
	Spesori nominal	mm	4	
	Karakteristika te tjera			
	Pesha e kabllit	kg/m		
	Rezistenca maksimale DC ne 20 ⁰ C	OHM/km		
	Rezistenca maksimale AC ne 70 ⁰ C	OHM/km		
	Rezistenca maksimale e skermos metalike DC ne 20 ⁰ C	OHM/km		
	Kapaciteti i Rrymave te LSH per temperature percjellesi 90 ⁰ C dhe temperature finale prej 250 ⁰ C per kohezgjatje te LSH prej 0.5s	kA		



Vizatimet.pdf

Shënime:

- i. Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.**
- ii. Kudo ne Specifikiet Teknike ku eshte cituar standard ndërkombëtar, do te pranohet edhe cilësim ekuivalent nga një institut vendor.**

Shtojca 6.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

GRAFIKUT I ZBATIMIT TË PUNIMEVE

Afatet e realizimit të punimeve: 1 muaj nga hyrja ne fuqi e kontrates.

<i>I</i>	<i>2</i>	<i>3.Afati i realizimit</i>				
Nr	Përshkrimi i Punëve	Java 1/Muaji 1	Java 2/Muaji 2	Java 3/Muaji 3	Java 4/Muaji 4	Java 5/Muaji 5
1.						
2.						
3.						
4						

Shënim. Autoriteti/enti kontraktor mund të shtojë rreshta në varësi të zërave të punimeve dhe kollona në varësi të afatit të parashikuar për realizimin e tyre.

Shtojca 7.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 8.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme përvërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas pikes 1 te kesaj shtojce.

2.2. Per kapacitetin ekonomik dhe financiar:

2.2.1 *Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë xhiro minimale vjetore të realizuar, për periudhën e 3 (tre) viteve të fundit financiare, te paktën 13,000,000 (trembëdhjetë milion) Lekë.*

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Si prove per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje vertetim nga Administrata Tatimore ku te tregohet xhiroja vjetore per vitet e siperpermendura.

2.3 Per kapacitetin teknik:

2.3.1 *Operatori ekonomik ofertues për të provuar përvojën e mëparshme, duhet te ketë realizuar të paktën:*

- a) *punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 6,500,000 (gjashtë milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;*
- b) *punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më të vogël se 26,000,000 (njëzet e gjashtë milion) lekë pa TVSH.*

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme, OE Ofertues duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, OE Ofertues duhet të paraqesë si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara ne organet tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

- 2.3.2 *Operatori ekonomik ofertues duhet të jete i pajisur me licence profesionale, në fushën e zbatimit të punimeve, leshuar nga organet përkatëse, e cila të përmbajë kategoritë e mëposhtme:*

Punime të përgjithshme ndertimi:

Kategoria NP-1	Punime gërmimi në toke	Klasifikim A
Kategoria NP-11	Ndertime për N/Stacionet, kabinat e transformatoreve linja e TN e të mesme dhe shpërndarjen e energjisë	Klasifikim A

Shënim: Në rast pjesëmarrjeje të një Operatori ekonomik të huaj, ky i fundit, Licencën e mesipërme me kategoritë e përshkruara, duhet ta ketë të njëjshuar pranë organeve përkatëse në Republikën e Shqipërisë sipas legjislacionit të saj në fuqi.

- 2.3.3 *Operatori ekonomik ofertues për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale duhet të ketë të punësuar të paktën 1 (një) drejtues teknik/inxhinier elektrik.*

Drejtuesi teknik duhet të jetë i siguar dhe të figurojë në listepagesat përkatëse E-Sig për 3 (tre) muajt e fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës.

Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë: kontratën individuale të punës, shoqëruar me diplomën përkatëse të inxhinierit të mesipërme, dëshmi IQT, si dhe listepagesat për periudhën e kërkuar.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

- 2.3.4 *Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka fuqinë punëtore të nevojshme minimalisht 4 (katër) punonjës, nga të cilët 1 (një) punëtor i thjeshtë me kohë të plotë pune, 2 (dy) specialistë me kohë të plotë pune, dhe 1 (një) shofer manovrator për realizimin e objektit të prokurimit. Punonjësit duhet të jenë të siguar të paktën për 3 (tre) muajt e fundit nga data e publikimit të kontratës.*

Shënim: *Punonjësi i kërkuar 1 (një) shofer manovrator, mund të disponohet edhe me kontratë shërbimi, nëse nuk është pjesë e stafit të OE ofertues.*

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

2.3.5 *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë minimumi 2 (dy) punonjes, të pajisur me kartela personale të sigurimit teknik, nga të cilët 1(një) të jete punonjes me kategorinë e sigurimit teknik IV-V, të leshuar nga shoqëri të akredituara në bazë të Ligjit Nr. 8734, datë 01.02.2001 "Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike", i ndryshuar, "Rregullore e sigurimit dhe shfrytëzimit teknik për impjantet, pajisjet dhe instalimet elektrike"*

Lidhur me këto pike, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë:

- i. Listpagesat E-Sig të punonjesve të sipercituar si dhe*
- ii. Kartelat përkatëse të vlefshme të sigurimit teknik.*

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

2.3.6 *Operatori ekonomik ofertues për përmbushjen e kontratës duhet të dëshmojë se ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike të nevojshme, si më poshtë vijon:*

Nr.	Mjetet	Sasia
1	Autovinc deri në 5 ton	1 cope
2	Eskavator 0.25 m ³	1 cope
3	Auto Vetshkarkuese	1 cope

Si dëshmi për plotësimin e kësaj pike operatori duhet të disponojë:

- a) Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshëm).*
- b) Për mjetet e siguruar me qira, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (të vlefshme) si dhe leje transporti, duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse noteriale të qirasë. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të paraqiten aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.*
- c) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publikë duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij.*

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë që mallrat e furnizuara janë të reja (jo të rikonstruara).

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues që do të realizojë këto kontrata, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat përkatëse të vlefshme të ISO, të leshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, që kanë lidhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- ✓ ISO 9001: për Sistemin e menaxhimit të cilësisë.
- ✓ ISO 45001: për Sistemin e menaxhimit të sigurisë në punë.
- ✓ ISO 14001: për Sistemin e menaxhimit mjedisor.

2.3.9 Për listën e mëposhtme të mallrave:

- ✓ Muftë bashkuëse për kabllot (sipas specifikimeve teknike)
- ✓ Kabllo fuqie 110 kV, me izolim XLPE, (1x800) mm²

Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

1. Autorizim të prodhuesit/distributorit të autorizuar për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

2. Katalog/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit, për listën e materialeve të mësipërme që do të ofrohen, në të cilën të paraqiten të dhënat teknike bazë të përkthyer në gjuhën shqipe.

Shënim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin.

3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dëshmi të testimeve zyrtare të kryera, të leshuara nga institucione të autorizuar ose nga prodhuesi të kryera me pare, që vërtetojnë pajtueshmërinë e materialeve të prodhuara (lista e mësipërme ose të ngjashme) me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara.

2.3.10 Në funksion të plotësimit të Shtojcës 8 “Formulari përmbledhës i vetedeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet të japë të dhëna të qarta si Emer, Mbiemer, Ates, Amesi, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje të skanuar të dokumentit të identifikimit (shqiptar ose të huaj), për Administratorin/Administratoret e shoqërisë, Ortakun/Ortakët e shoqërisë, përfaqësues të ndryshëm të posacem të shoqërisë, drejtues të ndryshëm të shoqërisë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim:

- i. Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

ii. Ne plotesimin e “Formularit permblendedhes te vetedeklarimit”, ne piken “Deklaratë për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)”, OE ofertues duhet te shenoje ne menyre te sakte, si prove paraprake: degen e studimeve te punonjesve, si dhe profilet perkatese te diplomave, apo certifikimet e kerkuara, qe disponon per plotesimin e kriterëve te vecanta te kualifikimit. Keto deklarime do te shqyrtohen kur OE ofertues do te paraqese dokumentet origjinale ose kopje te noterizuara per punonjesit, përpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit. Keqinformimi dhe deklarimi i rreme me qellim kualifikimin e ofertes, ne menyre te padrejte, sanksionohet nga pika 1/a, te nenit 78 “Perjashtimi per nje periudhe te caktuar nga Agjencia e Prokurimit Publik”, te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik” i ndryshuar.

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik

_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

PJESA I: A. INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik

(nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: <ul style="list-style-type: none">Informacione për nënkontraktorin

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: SHKAQET E PËRJASHTIMIT

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, Deklaroj Se:

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër⁵.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:

çmimet;
metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

⁵ Për qëllim të kësaj deklaratë dhe ofertës së paraqitur, fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

C: DEKLARATA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

